



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1091/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Burim Ademi kryesues, Ferki Xhaferi dhe Adnan Konushevc, anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatës për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Gjilanit Silvana Petrovic nga Subjekti Politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, dega në Gjilan, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 09.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet si i bazuar apeli Anr.1091/2021 i datës 08.11.2021, kandidatës për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Gjilanit Silvana Petrovic nga Subjekti Politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, dega në Gjilan, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 më të cilën ka kërkuar rinumërimin e votave në vendvotimet: 0428D/01D dhe 0434D/01D në Komunën e Gjilanit.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për Kandidat për Kuvend Komunal nga Subjekti Politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, dega në Gjilan në vendvotimet: 0428D/01D dhe 0434D/01D.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutitë në Vendvotimin si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 08.11.2021, ka pranuar apelin Anr.1091/2021 (përmes postës të datës 04.11.2021), i paraqitur kandidatës për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Gjilanit Silvana Petrovic nga Subjekti Politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, dega në Gjilan, me të cilën pretendon se në vendvotimet 0428D/01D i mungojnë 6 vota ndërsa në vendvotimin 0434D/01D i mungojnë 2 vota andaj kërkon që të bëhet rinumërimi i këtyre vendvotimeve.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura, në apel në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Gjilanit Silvana Petrovic nga Subjekti Politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, dega në Gjilan kërkon rinumërimin e votave në vendvotimet e lartcekura, PZAP pas shqyrtimit të apelit erdhi në përfundim se apeli i paraqitur nga kandidatja në fjalë për rinumërimin e votave për vendvotimet e lartcekura është i bazuar .

Paneli vlerëson se apeli është i bazuar sa i përket vendvotimit të vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi, nga se rezulton se në Formularin e Rezultateve të Kandidateve kandidatja për Kuvend Komunal Silvana Petrovic, nuk e ka asnjë votë, ndërsa sipas deklaratës së apelueses të bashkangjitur në apel e që ndërlidhen me këto VV, deklaron se ka gjithsej 8 vota, mirëpo këto votë nuk rezulton të jetë në rezultatin përfundimtar të shpallur nga KQZ-ja, prandaj paneli konstaton se ka mospërputhje të rezultatit përfundimtar me deklaratën e votuesit andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së e urdhëron KQZ-në që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve në vendvotimin e si në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi..

Andaj ky panel, vlerëson se rinumërimi në këtë vendvotim e bënë procesin e rinumërimin të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e rinumërimin të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparenca, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës së lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimin, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli me qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze*, gjithashtu në mbështetje të nenit 117.4 dhe po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 dhe 120 par. Pika d) të LZP-së, urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimin e lartcekur duke vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.1091/2021 më datën 09.11.2021.

Kryesues i Panelit

Burim Ademi

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimin të këtij vendimi.

